Lebit Murtishi
Dolli
e
gjakut
(poezi)

Lebit Murtishi

Dolli e gjakut

poezi

Autori:
Lebit Murtishi

Redaktoi:
Kadri Sherifi

Lektor:
Isuf Ismaili

Kopertina dhe
Përkujdesja kompjuterike:
Kadri Sherifi

Lebit Murtishi

DOLLI E GJAKUT

(POEZI)

2008

Bota...

bota është ç`nderuar
bota ka humbur nderë
bota kërkon që të shtrohet
bota gjëkundi do pjellë...

do pjellë botë e ç`nderuar
do pjellë në qoshe kopilë
do pjellë se duhet të pjellë
bota që fle me bacilë...

Kotësi...

Kotësi e pakuptimtë
të duket shiu në vjeshtë,
të duket se lahen çatitë
siç lahen pas turpit çingjitë,

kotësi të duket shiu
që s`vinte në verën e nxehtë
kur toka e priste e etur
me sytë nga qielli të tretur,

kotësi të duket shiu
kur kokën ke plot kotësira,
kur shtrihesh e pret nëpër hije
herë kohë me diell, her` shira...

Ah Kadri-Mitrovica!

S`di nga më erdhe në poezi
he burrë i lashtë si një
hyjni...
për një grusht dhè kur bëhesh
fli
m`i përndez këngët brenda në
gji...

nga vjen he burrë me degë ulliri
me gjoksin shqyer e djegë nga zjarret,
mos je Feniks i dalë nga hiri,
apo je Gjergji i dalë nga varret!..

Mërgim...

sa pak,
sa pak tymtarë tymojnë
qiellit,
sa vatra heshtin, se shuar
janë,
sa djepa presin një këngë
nën hatull,
sa vasha mbesin me ëndrrat
akull!
sa pak tymtarë tymojnë qiellit,
fate të zhbërë rendin pas diellit...

Kurth!

një marimangë
kotet nën ferrë,
në erë tulatet
flutur e mjerë...

I vonuar!..

një shekull udhë të bëj
m`u desht,
një shekull udhë harruar
qesh,
kur s`pata këmbë eca me
duar
në fund më thanë je i vonuar!..

Kosovë!

kur unë mendova
se gjete paqen
të humbur udhësh
shekujsh kopilë
sërish ca djersë ballit të shkojnë,
sërish ca thika trupin ta shpojnë...

mbahu kosovë
me zorrët zvarrë
le t`hapë ky shekull
mbi ty një varrë
mos mbesë pa pirë dollin e gjakut
edhe ky shekull me bijt e djallit...

Atdhe!

një fjalë e thënë
në çdo lloj kohe
për ty është pak,
pak, pak, pak...

në më kërkofshin
ditët e tua
do jap dhe gjak,
gjak, gjak, gjak...

Nipi im...

Albini bëri hapin e parë
dhe mori udhët si unë dikur,
i them: ngadalë o djal i mbarë
kur i puth hunda në ndonjë gur...

udhët i mori sot nipi im
pa frikë nga gurët që i zënë udhë,
më thotë: gjysh, pusho tash ti
aty ku mbete do nisem unë...

Kur kam mall...

(Lasgushit)

kur kam mall për dashurinë,
mall i shpirtit kur më djeg,
të kërkoj tek Shendaumi,
të kerkoj në ndonjë breg...

të kërkoj i llahtaruar
lart ndër yjësit e qiellit,
ti si dallgë e trazuar
del nga Shpirti i liqenit...

Jusuf Gërvallës...

Të kërkova, Diell i dehur
për një çik pranverë,
ti kërkova sytë e etur
mbushur me ylberë...

të kërkova botë më botë
udhësh arratisur
por t`i gjeta vetëm yjtë
n`kraharor qendisur.

dhe të pashë nëpër qiej,
mes engjujsh të pashë
dhe t`i pashë sytë e lodhur
mbi Atdhen` e lashtë...

Gjallë je...

(Sulltan Mehmetit)

Ti preu udhët errësira,
Të mbushi gjoksin me rrufe,
S`dijmë në ç`anë të qiellit fshihesh
Po ti je gjallë këtu ndër ne...

Gjallë je e gjallë do mbetesh
Sot e mot e përjetësisht,
Rron e rron e s`do të vdesësh
Si çdo shkëmb në Ladorisht...

Në veleshtë digjet një prag

(martirit, Inajet Istrefi,
vrarë nga çetnikët serbë në vitin 1986)

u këput një copë rrufeje
dogji pragun e shtëpisë
u përplas një degë lisi
permbi troll të arbërisë...

numëroi plumbat gjoksit
nën e veshur në të zi,
hallall bir të qoftë gjiri,
ndryshe s`bëjmë Shqipëri.

varg i motrave në derë,
ligjërojnë me ligj te pragu
vëlla të kërkon shtëpia,
vëlla të kërkon konaku

mos më qani tha martiri
se një ditë do kthehem prap,
kur të vijnë zogjt e lirë
me flamur do jem nën rrap...

bie shi...

rrugë të shkreta,
kuisje langojsh,

pret një prostitutë
fatin në një qosh!..

ç`panoramë e djalltë,
ç`panoramë e ftohtë...

Irrationalis...

ta zbres hënën ndonjë natë
ta shtroj si vashën në lëndinë
të fik dhe dritat varur qiellit
të mos shohë bota ç`mendurinë...

të fshihen yjt` e kuq pas reve,
mos shohin zhveshur një të marrë,
mos shohin hënëzën e shtrirë
me flokët derdhur nëpër bar...

Udhëve të Prizrenit

Në çdo skaj të kti qyteti
Të hirshëm si nuse me nur
Imazhe të hershëm të fshehur
Frymojnë në udhët me gurë...

I ndiej dhe zërat e largët
Të zbritur nga rrethi i shtatë
Dhe hoqa duart nga xhepat
Se rruga na qënkësh e gjatë...

Xhemajli Berishës

U njohëm në kohë shirash
mes motesh të pazakontë,
mes qiellit të zymtësuar
mes udhësh të mbetur pa shteg...

të pashë tek ikje yjesh
tek ngjiteshe si vetimë
fanar mbaje në duar
që udhët të marrin dritë.

Jo, i thoshe troç satanit,
jo, i thoshe errësirës
fanarët që kam në duar
nuk i shuajnë dot rrufetë...

dhe fanarët hapën shtigjet,
shtruan udhët e 1irisë
ti mes yjesh lartë ike
t`i bëjshë dritë Shqipërisë...

Ditëlindja ime!

sonte festojmë vetëm
unë e shpirti im,
njëri rri në qoshe
tjetri i bërë tym...

gëzuar i them
me dolli të shprazët,
gëzuar ma kthen
shpirti im i largët...

Fotografitë

I dua shumë fotografitë
jo pse e pëlqej vetvehten
por dua ta shoh drejtë në sy
atë që iku me të djeshmen!..

Je ti

ajo je ti
mos thuaj jo
i thuaj syve mos gënjejnë
diellehënë je përzier
je ti udhët mbush me dritë
atje ku diejt perëndojnë...

Hija që mbeti në breg

sy të braktisur
refren që dhemb
m`ndjekin ëndrrat
udhët m`i zënë

ku të gjejë dalje
ku të gjejë shteg
po më ndjek hija
mbetur në breg...

Syt e tu

seç më ngjajnë me sy qielli
ujvarat që ke nën vetull

Zot më thuaj në janë këngë
a janë vargje poezish

nëpër shpirt ç`më fluturojnë
ata zogj prej kaltërsish...

Pesimizëm!

sa keq,
të lodh shprazëti
                e ditës

e nesërmja imagjinare
mbytet
brenda teje

sa keq...
brenda vetes
gur sizifi të jesh...

Kam dëshirë...

këngë legjendash
me gjuhë lisash
                    të këndoj

ninulla gjethesh
me gjuhë ere
                    të këndoj

vetëm lirika
me gjuhë dallge
nuk më lë malli
                    të këndoj...

Mos...

mos loz me lotin
ti kanibal
i kohës sime,

loti këlthet
kur dhëmbët ngulen
në palcë të ndjenjës,

mos loz me lotin
ti kanibal
me gjak te helmët...

Thinjët e mia...

thinjët e mia
janë stinë të përsëritura
në kopshte mendimesh
                    të ngrira...

janë gjuhë pa fjalë
e shprehur
mes heshtjes sime
                    të zhurmët...

Mbrëmje vere në qytetin X...

më dukej
sikur perëndoja edhe unë me diellin
dhe sikur prekja majat e ëndrrave
ku fshihej një mall i përtëritur
për kohën që dhimbshëm rrëshqiste
drejt caqesh të panjohur
e linte aq gjurmë dhimbjeje
në qenien time të lodhur

qiellit vezullonin yj të skuqur
si qirinj të ndezur
për t`i dhënë edhe më shumë afsh
mbrëmjes së ndezur
që ndizte pahetueshëm ëndrrat e mia
të hershme

e unë
ulur isha
mbi një minder allaturka
që më ngjante me një breg ëndrrash
                    të mërzitshme
dhe prisja me sytë ngulur tek porta
                    gjysëm e hapur
të shfaqeshe ti dhe të më zgjojë
nga kjo ëndërr e lodhëshme
akrepat e orës
kishin humbur ritmin e kohës
dhe si përdhunshëm matnin
thyerjet e zemrës sime të akullt

koha s`rrokullisej
diku mes rrugësh kish mbetur si gur
i ftohtë
dhe sikur deshte ëndrrën e çmendur
në pellgje dhimbjesh ta fundosë
ti
ishe në rrugë e dashur
të ndjeja tek vije mes frymëmarrjesh
të çakorduara
që zorshëm i përballonte kraharori yt
i virgjër
e ndjeja hapin tënd
tek shkilte pa ndrojtje mbi kohët
për t`i dhënë udhë pranverës tënde
të parë

të ndjeja aq shumë..sa...
në çastin kur i kryqëzuam sytë
m`u duk vetja si dallgë e çmendur
ndërsa ti si një anije pa timon
që kërkonte portin e humbur
për të hedhur spirancën e dëshirave
                të përndezura
në bregun e shpëtimit
të ndjeva...
të ndjeva të tërën si flakë
                në kraharor
t`i ndjeva sytë e kaltër
të etur për mëkat...

Udhëtim...

flejnë udhëtarët
e lodhshëm

kërhatje të përziera
kërleshen me njëra-tjetrën
për të nxjerrë vrerin
q`u fle në gjoks...

unë e vozitësi
rrimë zgjuar,
ai mban timonin,
unë mendime bluaj...

Sa keq...

u thye një gotë,
u shndërrua në hi,
                    në hiç,

askujt sì erdhi keq,
të gjithë i rrudhën këmbët
nga dromcat e imëta të xhamta,

sa shpejt u harrua
ajo që u shuante etjen
                    dikur...

Paradoks!

burri nuk guxon të qajë
në gaz,
as në mort...

kështu thanë
ata që s`ndjenë
ç`peshë ka një pikë lot...

Gostivar...

këta njerëz
me strajca krahësh
dikur
vriteshin për Flamur,

sot rrëshqasin
si të humbur
siç rrëshqet një gur...

njëri qan
kur tjetri niset,
i treti seç pret,

zgjaten sytë
përtej udhësh
ah, gurbet i shkret!..

Ali Pashë Tepelenës

Të lanë të gjith` Pasha,
I par` e i mbram`-siç thonë,
Veç magjia-Vasiliqi
Të mbeti si medaljon,

Mbete vetëm me një grua
Që besë s`i zure kurrë,
Por magjia-Vasiliqi
T`mbajti peng, he goxha burrë,

Të ikën miqë dhe shokë
Kur u tund mur i kalasë,
Veç `i numër nam të mbeti
Dhe Vasiliqi në krahë...

Këngët e mallit tim

këngët e mia të mallit
rrjedhin si lumë i paanë
kanë fill-mes e tejzgjatje
po fundin s`dijnë ku e kanë,

Ku venë këngët e mia,
ku ikin këngët e mallit,
ndoshta nuk ndalen pa mbytur
dhe lajkat e fundit të djallit...

Kush di të më thotë...

me ç`zëra të godas
zërat e satanës
që zhvirgjërojnë yjtë...

e ç`këngë të këndoj
për veshin e shurdhët
që po vdes në gjumë...

kush di të më thotë...

Tokën time...

e dogjën
gjer në palcë
që lulëkuqja
erë shkrumbi të bie

e pranverës
rrugë kthimi mos i mbesë...

Toka ime e djegur
Nuk ditka të vdesë...

Brengë...

ti rritesh si ferrë,
anëve të Shpirtit
vragë dhimbjesh çel,

të falem o brengë
që s`më le në gjumë
të vdekur për herë...

të falem o brengë...

Heshtje...

kur shpresa bie
copëra-copëra
pafundësisë së kotë
të pritjes...

një syth i ri
nga dhimbje e vjetër
i hap një shteg
pranverës tjetër...

Ata do vijnë

ata që flejnë
me rrobat veshur
me gjokset shoshë
nga shira plumbash

do vijnë një ditë
a ndonjë natë
se s`i ze gjumi,
se ka shtrëngatë...

Pritje...

fërfërijnë gjethet e mollës,
mbi mur mjaullin një mace,
një merimangë tek thur një
rrjetë,
m`u lodhën sytë
porta s`kërcet...

Siluetë!

flokë të shprishur
rrahur nga era,

fatamorganë
e Shpirtit tim...

Lutje mërgimtari

më ndje oj tokë
o ujë o ajër
më ndje o diell
më ndje oj vatër,

më ndjeni zogj
në qiellin gri
më ndjeni këngë
të dheut tim,

më ndje oj sofër
e larë me lot
që lashë Atdhenë
më ndje o Zot!

Pa titull!

S`dua ta kthej kokën pas
e në të njëjtin pus të bie
dhe humbje të njëjta të numëroj,

as premtime përallash për parajsën
që më pret pas maja dhimbjesh, s`dua
                                    të ndëgjoj
të ec dua me këmbët e mia
gjer buzë varrit e varrit t`ia them
çdo fjalë përgjysmë të mbetur në udhë,
mbase do kuptoj pse s`desha sup më sup
të më mbajnë të vdekurit të gjallë
                                    në tabut...

Migjeniane

a keni parë fëmijë të shtrirë
faqen mbi prag të ndonjë dere,
a keni parë në sytë e mpirë
lotin e tharë për një kothere...

a keni parë sy të pangirë
që s`njohin orë as dit` as mot,
a keni parë shpirtra të dlirë
që fiken dhimbshëm mbi këtë botë...

dhe keni parë kohët lavire
që vijn` nga terri i lashtë me vrap,
dhe keni ndjerë ç`këngë këndoi
Migjeni mjerë mbi këtë prag...

Më ik vehtja...

nuk dua,
por vehtja më ik
pas çdo kënge,
pas çdo fjale,

pas çdo zëri që vjen
nga kohët e perënduara...
-më ik vehtja
-më besoni
tek shoh sykaltra
                e syzeza
më ik vehtja
si i pabesi, që ik
            nga vdekja...

Hija nën dallgë...

deti ka marrë hanxhar në dorë,
deti ka dallgë gjer në Shpirt,
deti kërleshet gjer në vdekje
dhe ngrihet prapë mbi stuhitë...

bie një dallgë e përgjakur
dhe faqet shtron mbi ndonjë gur,
aty ku hijet lanë dashnorët
në ndonjë natë me hënë dikur...

Këngë e vjetër

i mbyllur si murgu i heshtur
mes muresh si varre të ftohtë
dëgjoja një këngë të mbetur
si dhimbje kronike ndër kohë...

dhe muret dhe xhamat e heshtur
u shkrinë me këngën e vjetër,
dhe pash` në pasqyrë vetveten,
dhe desha të isha një tjetër...

Nipi im

Nipi im
të flasë ka zënë:
-babi, mami
thotë edhe nënë...

po gjysh kur thotë
i fërkon sytë
tek sheh në mur
fotografitë...

Paradoks!

Jetoj nën lëkurë të huaj
i fshehur si një fantazmë,
ushqehem nga djersë e huaj
dhe fle me një grua të huaj...

pranë jetës e varrit vërtitem
njëkohshëm i gjallë e i vdekur,
jam paradoksi i kohës
mes udhëkryqesh i mbetur...

Ajo...

ajo e deshte liqenin,
i deshte maniret e tij,
i mbushte sytë me dallgë
dhe flinte në krahët e mi...

i deshte rënkimet e ujit
dhe dallgët e marra në breg,
veç rekuiemin e mjellmës
s`e deshte në bregun e shkretë...

Rekuiem Lisit...

i ranë sopatat tinëzare
dhe ra si trimi në luftëra
që ballin përgjakur nga plumbat
e shtron në barin e tharë...

as zogjtë që mbajti në supe
s`i ndjenë rënkimet e tij,
as karvanarët e lodhur
që hije u bënte dikur...

dua të ik...

për herë të parë ndjeva lodhjen,
ç`lodhje e nemur, dreqi e marrtë,
dhe thashë të nisem të gjej paqen
diku me engjujsh, atje lartë...

të bëhem avull reshë të bardha,
të rrugëtojë qiellit gri,
poqese paqe s`gjej nga malli,
do kthehem prapë si një pikë shi...

hipokrizi...

një ditë do nisem
për udhë të gjatë,
do ngjitem ndër yje
vetëm fillikat...

do të kruaj sytë
me mall hipokriti,
do thotë: “si iku
rahmet i past` Shpirti”!..

do t`i them të mjerit
ca fjalë nga qielli:
“mos më ndot kufomën
ti o qen bir qeni”!..

Zambaku...

U thave një ditë. U thave
se duhej të thahesh. Etje
mbase pate për sytë që s`të panë
kur zjarret të ranë e fletë s`të
lanë...

...relativitet...

s`jemi moshatarë baba,
unë siç duket jam më plak,
mos qesh se nuk bëj shaka,
Zoti s`njeh pasojë dhe shkak...

Yjt e shpresës...

yjt e shpresës hungërijnë
si kuaj mbetur pa zot
në mes të fushës,
në mes të gjakut...

plagosur janë
yjt e shpresës
e plagët lidhin
me këngë e lot...

Fjalë e humbur...

jam çudi e çudive,
qaj me fjalët e mia,
më duket se qajnë dhe
fjalët
jetimë të lëna mbi letër!..

herë, më duket jam fjalë,
herë një letër e shkruar,
ndaj më qahet më shumë
për fjalën e mbetur pa udhë!..

Vendlindje...

s`i kam haruar
këngët e tua...

edhepse humba
të Shpirtit paqe...

tinguj e fjalë
ngujuar janë...

në çdo pik loti
që rrjedh në faqe...

Përmbajtja:

1) Bota..._____ 5
2) Kotësi..._____ 6
3) Ah Kadri-Mitrovica!_____ 7
4) Mërgim..._____ 8
5) Kurth!_____ 9
6) I vonuar!.._____10
7) Kosovë!_____11
8) Atdhe!_____12
9) Nipi im..._____13
10) Kur kam mall..._____14
11) Jusuf Gërvallës..._____15
12) Gjallë je..._____16
13) Në veleshtë digjet një prag_____17
14) bie shi..._____19
15) Irrationalis..._____20
16) Udhëve të Prizrenit_____21
17) Xhemajli Berishës_____22
18) Ditëlindja ime!_____24
19) Fotografitë_____25
20) Je ti_____26
21) Hija që mbeti në breg_____27

22) Syt e tu _____28
23) Pesimizëm!_____29
24) Kam dëshirë..._____30
25) Mos..._____31
26) Thinjët e mia..._____32
27) Mbrëmje vere në qytetin X..._____33
28) Udhëtim..._____36
29) Sa keq..._____37
30) Paradoks!_____38
31) Gostivar..._____39
32) Ali Pashë Tepelenës_____40
33) Këngët e mallit tim_____41
34) Kush di të më thotë..._____42
35) Tokën time..._____43
36) Brengë..._____44
37) Heshtje..._____45
38) Ata do vijnë_____46
39) Pritje..._____47
40) Siluetë!_____48
41) Lutje mërgimtari_____49
42) Pa titull!_____50
43) Migjeniane_____51
44) Më ik vehtja..._____52
45) Hija nën dallgë..._____53

46) Këngë e vjetër_____54
47) Nipi im_____55
48) Paradoks!_____56
49) Ajo..._____57
50) Rekuiem Lisit..._____58
51) dua të ik..._____59
52) hipokrizi..._____60
53) Zambaku..._____61
54) ...relativitet..._____62
55) Yjt e shpresës..._____63
56) Fjalë e humbur..._____64
57) Vendlindje..._____65
58) Përmbajtja:_____66